



OLIMPIADA KOMBËTARE E GJEOGRAFISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 12

03 shkurt 2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Ndër elementët më të diskutueshëm në peizazhin kulturor janë muret dhe barrierat e ndërtuara për të krijuar kufijtë mes popujve apo shteteve.
- a) Identifikoni dy shembuj të mureve ose barrierave të ndërtuar në shekullin XX dhe XXI dhe qëllimin e ndërtimit të secilit prej tyre. **2 pikë**
- Muri SHBA-Meksikë- për të kontrolluar fluksin e madh të emigrantëve nga Meksika
 - Muri i Berlinit – për të penguar gjermano lindorët të largoheshin drejt Gjermanisë perëndimore
 - Zona e çmilitarizuar midis Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut- të shërbente si një zonë neutrale për të reduktuar mundësitë për dhunë.
 - Muri Izrael –Palestinë – si një masë sigurie në situata të tensionuara.
 - Etj.
- b) Shpjegoni pasojat me të cilën janë përballur vendet përgjatë kufirit të tyre në aspektin politik, social, ekonomik dhe mjedisor. **8 pikë**

Pasojat politike:

- Rritet tensioni midis vendeve fqinje dhe qytetarëve.
- Rritet izolimi.
- Promovohet nacionalizmi, reduktohen influencat e huaja, rritet ksenofobia.
- Kalimi i kufirit në mënyrë ilegale bëhet i rrezikshëm.
- Censurë e brendshme.
- Rriten masat e sigurisë.

Pasojat sociale:

- Rritet komunikimi virtual midis popujve të vendeve fqinje.
- Rritet imagjinata për mënyrat se si mund të kalohet kufiri.
- Reduktohen migrimet sezonale.

Pasojat ekonomike

- Kostoja e ndërtimit, mirëmbajtjes.
- Rritet punësimi (ndërtimi, mirëmbajtja etj.).
- Reduktohet kalimi i mallrave në mënyrë ilegale, kontrabande.
- Më pak mundësi punësimi (për të përjashtuarit), më pak remitanca për të afërmit.
- Humbja e krahut të lirë të punës.
- Rritet kostoja e kontrabandës (njerëzit, mallrat, droga).

Pasojat mjedisore

- Ndërpritet migrimi i specieve të ndryshme.
- Nuk është estetike për mjedisin, plagë urbane.

2. Në disa nga vendet evropiane është vënë re një rritje të popullsisë myslimane në dekadat e fundit. Shtete të tilla si Franca, Gjermania, Holanda etj., dallohen për një përqindje të lartë të popullsisë myslimane.

a) Jepni një nga arsyet e rritjes së popullsisë myslimane në këto shtete.

1 pikë

Franca: Imigrimet nga ish kolonitë e Afrikës Veriore.

Holanda: Imigrimet nga ish kolonitë e Indonezisë dhe Surinamit.

Gjermania: Imigrimet nga Turqia dhe ish-Jugosllavia.

b) Analizoni impaktin e rritjes së popullsisë myslimane, në këto shtete, në strukturën e popullsisë, organizimin urban dhe lidhjeve shoqërore.

9 pikë

Në strukturën e popullsisë

Nivele të larta të lindshmërisë.

Ndryshon struktura e popullsisë (popullsia myslimane është më e re).

Ndryshimi i strukturës gjinore, për shkak të numrit më të lartë të meshkujve që përfshin procesi i emigrimit.

Në organizimin urban

Krijimi i lagjeve etnike.

Bizneset, marketet, xhamitë në zona specifike.

Krijimi i grupimeve, ndarjeve etj.

Në lidhjet shoqërore

Rritet tensioni social (kulturore, politike, në drejtim të punësimit).

Perceptohet si kërcënim për unitetin kombëtar.

Gjermania ka bërë ndryshime në rregullat e dhënies së nënshtetësisë për emigrantët.

Kontribuojnë me kulturën e tyre në kulturën e popullsisë vendase etj.

3. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

Tema e esesë: Efektet e mundshme të ngrohjes globale në Holandë.

10 pikë

Ngrohja globale sot është një shqetësim për të gjitha shtetet. Megjithatë disa prej tyre gjenden më shumë nën presionin e kësaj dukurie. Njëri prej tyre është Holanda.

Detyrë:

Përshekruani pozitën gjeografike dhe kushtet e relievit të Holandës.

Analizoni pse Holanda është një nga ato shtete që gjendet nën presionin e ngrohjes globale.

Pikat mbi të cilat duhet të mbështetet nxënësi për esenë:

Holanda shtrihet në veriperëndim të Evropës me dalje në Detin e Veriut.

Vija bregdetare e Holandës është 451 km, ndërsa ajo tokësore 1027km.

Relievi i Holandës është i ulët.

Lartësia maksimale e saj është 322m.

Rreth 50% e sipërfaqes së Holandës gjendet deri në 3m mbi nivelin e detit.

Rreth 1/4 e sipërfaqes së saj gjendet nën nivelin e detit.

Zhvillimi i esesë duhet të përqendrohet tek pasojat e ngrohjes globale, të cilat Holanda do t'i përjetojë më shumë se çdo shtet tjetër për shkak të relievit të saj.

Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

4. Shkruani një ese të mirë organizuar që përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

Tema e esesë: Veçoritë fiziko – gjeografike mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në zhvillimin e një vendi apo rajoni. **10 pikë**

Detyrë:

Zgjidhni një tipar fiziko – gjeografik dhe shpjegoni se si ky tipar ka patur efekt në zhvillimet historike të dy vendeve apo rajoneve. Sigurohuni të përfshini shembuj specifikë.

Shënim: Mund të merrni në konsideratë të tilla tipare fiziko – gjeografike: lugina lumore, male, fusha, pyje, klimë si për shembull: lumin Nil, oqeanin Atlantik, Himalajet, shkretëtirën e Saharasë, detin Mesdhe etj.

Ju **NUK** jeni të kufizuar në këto zgjedhje, mund të merrni në konsideratë edhe shembuj të tjerë.

Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.

5. Shkruani një ese të mirë organizuar, e cila përfshin hyrjen, disa paragrafë që kanë lidhje me detyrat e mëposhtme dhe një përfundim.

Tema e esesë: Suksesi i industrializimit u shoqërua me probleme të mëdha mjedisore në gjithë botën.

Me fillimin e shek. XXI disa shtete janë përpjekur të marrin në konsideratë problemet mjedisore.

10 pikë

Detyrë:

Analizoni problemet që industrializimi i ka shkaktuar vendeve të botës.

Shpjegoni se si këto vende po përpiqen të reduktojnë problemet e shkaktuar nga industrializimi.

Eseja në gjeografi do të vlerësohet për këto aspekte:

Hyrja / prezantimi – 2 pikë

Tregohet se për çfarë bën fjalë eseja.

Jepet një sfond për temën, rëndësinë e saj.

Jepen idetë/çështjet/ temat kryesore që do të trajtohen dhe radha në të cilën do të diskutohen ato.

Zhvillimi i argumenteve/analizës – 6 pikë

Shpjegohet këndvështrimi i nxënësit për temën e esesë. Argumenti zhvillohet teksa prezantohen pikëpamjet e nxënësit.

Trajtimi i çështjeve zhvillohet në një mënyrë sistematike dhe logjike dhe mbështeten me prova.

Përfundimi / konkluzionet – 2 pikë

Përfundimi është pika e fortë e esesë, ku shprehet qartë çështja kryesore dhe këndvështrimi i nxënësit për temën.